



# Akreditimi:

## Shtim i vlerës në zinxhirët e furnizimit



**Dita Botërore e Akredimit**

**9 qershor 2019**

(#WAD2019)

# Akreditimi: Vlera e shtuar në zinxhirin e furnizimit

## Cilat janë çështjet?

- | Edhe pse bizneset kanë prodhuar artikuj me mallra të marra nga e gjithë bota për shumë vite, zinxhirët e furnizimit tashmë janë shumë më komplekse në aspektin e shpejtësisë, përmasave, thellësisë, si dhe shkalla e ndërveprimit global.
- | Natyra globale e zinxhirëve të furnizimit dhe tregjeve me pakicë nënkupton që bizneset duhet të operojnë në mjedisë të shumta dhe shpesh të ndryshme rregullative.
- | Përcaktimi i cilësisë, autenticitetit dhe gjurmueshmërisë së lëndëve të para apo komponentëve kërkon informata të besueshme dhe kredibile.
- | Me përshpejtimin e inovacionit dhe shkurtimin e ciklit jetësor të produkteve, tregjet bëhen edhe më të paparashikueshëm dhe ushtrojnë trysni të rritur mbi zinxhirin e furnizimeve.
- | Bizneset duhet të menaxhojnë ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve apo pengesave nga thyerjet e sigurisë së të dhënave apo dështimet e sistemeve.
- | Përzgjedhja efektive e furnizuesve të qëndrueshëm, jo vetëm në kuptimin e stabilitetit financiar, por edhe performanca tek Përgjegjësia Sociale Korporative (CSR) praktikat etike.

Zinxhirët e furnizimit të produkteve janë përditë e më të globalizuar dhe komplekse, pasi që kompanitë synojnë të optimizojnë shpenzimet e tyre, derisa ruajnë fleksibilitetin. Zinxhirët e furnizimeve që shtrihen në shumë vende dhe lokacionet kanë sfida madhore në aspektin e cilësisë, pajtueshmërisë me rregulloret dhe standardet që kanë të bëjnë me sigurinë, por edhe përgjegjësisë mjedisore dhe sociale.

Prokurimi shpesh është përgjegjës për 70% të shpenzimeve të kompanive (*Burimi: Instituti i Certifikuar i Prokurimit dhe Furnizimit*), pra çdo pengesë e tillë mund të ndikojë në fitime, reputacion të brendit, apo besnikëri të konsumatorëve.

## Roli i akreditimit?

Akreditimi përcakton kompetencën teknike, integritetin dhe paanshmëria e organizatave që ofrojnë shërbime të vlerësimit të përputhshmërisë, si testimi, kalibrimi, certifikimi dhe inspektimi.

Akreditimi, mbështetur nga standardet e pranuar ndërkombëtarisht, i shton vlerë zinxhirëve të furnizimit, derisa bizneset synojnë të rrisin vlerën dhe të përmbushin kushtet e kontratave, derisa ruajnë një nivel besueshmërie që produktet përmbushin specifikimet teknike dhe janë të sigurta për përdorim.

80% e tregtisë përbëhet nga elementet e testimit, kalibrimit, inspektimit dhe certifikimit, bashkërisht njohur si vlerësimi i përputhshmërisë (*Burimi: OECD*). Akreditimi është vlerësimi i pavarur i atyre trupave vlerësues sipas standardeve të pranuar për të siguruar paanshmërinë, kompetencën dhe konsistencën e tyre.


Pra, akreditimi luan një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e kostos së tregtisë dhe biznesit, duke avancuar transferimin e teknologjisë, si dhe duke rritur investimet. Ky po ashtu i mundëson bizneseve

të integrohen brenda zinxhirëve globalë të furnizimeve pasi që mund të demonstrojnë cilësinë e produktit përmes një "gjuhe teknike" të përbashkët të nevojshme për të ndërtuar mirëbesimin mes partnerëve afaristë. (*Burimi: Banka Botërore*). Një raport nga Divizioni i Hulumtimeve Ekonomike dhe Statistikave të Organizatës Botërore të Tregtisë ka theksuar që përdorimi i parregullt i vlerësimit të përputhshmërisë përbën 10% të Brengave Specifike Tregtare (STC). Akreditimi ofron një mundësi për të adresuar këtë çështje.

### RAST STUDIMI

#### Pushteti lokal në MB

Këshillat lokale në Mbretërinë e Bashkuar marrin vlerësues të akredituar për të bërë matjet e azbestit në pronat e tyre. Akreditimi sipas standardit ISO/IEC 17020 siguron që këta vlerësues të jenë kompetentë, të pavarur e të paanshëm. Kjo i mbështet këshillat në hulumtimet e tyre dhe përzgjedhjen e furnizuesve për të siguruar marrjen e



## Sigurimi i besimit në Zinxhirin e furnizimeve

Duke marrë parasysh kompleksitetin e zinxhirëve të sotëm të furnizimeve, siguria e matjeve, testeve, inspektimeve dhe certifikimeve që bëhen në një juridiksion apo sektor tjetër tregu është esenciale. Pa një nivel besueshmërie, këmbimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve rrezikon të pengohet nga barrierat teknike apo nivelet e ndryshme të cilësisë, duke rritur kështu shpenzimet për importues e konsumatorë.

Kompleksiteti i tillë po ashtu e bën të pamundur në kuptimin e kostos që qeveritë apo rregullatorët të bëjnë testimin laboratorik, inspektimin dhe certifikimin e nevojshëm në mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë publike. Një zgjidhje që po zbatohet përditë e mëshumë nga qeveritë është

Vendosja e rregulloreve që specifikojnë kriteret që duhen plotësuar dhe procedurat që duhen zbatuar për demonstrimin e pajtueshmërisë, me opsionin që ofruerit e shërbimeve nga sektori privat të mund të marrin certifikimin për kryerjen e verifikimit të proceseve të përputhshmërisë.

Vlerësimi i përputhshmërisë, duke përfshirë aktivitetet si testimi, certifikimi dhe inspektimi, përdoret për të verifikuar që produktet dhe shërbimet të përmbushin standardet ose specifikimet teknike. Në sektorin e rregulluar, vlerësimi i përputhshmërisë demonstron pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, si dhe në sektorin vullnetar, ofron siguri për konsumatorët dhe importuesit që produktet dhe shërbimet ata ofrojnë plotësojnë specifikat.

Pasi që trupat e vlerësimit të përputhshmërisë janë kryesisht shoqëri tregtare, akreditimi vlerëson dhe deklaron kompetencën teknike të këtyre shoqërive, për të ofruar besim në rezultatet apo të dhënat e testeve të tyre.



## Mbështetja e zinxhirit të furnizimeve përmes njohjes ndërkombëtare

Trupat e akreditimit themelohen për të siguruar që laboratorët, organet inspektuese dhe trupat e certifikimit i nënshtrohen mbikëqyrjes nga një organ kompetent. Trupat e akreditimit të njohur ndërkombëtarisht, që janë vlerësuar nga të njëjtit si kompetentë, nënshkruajnë marrëveshje ndërkombëtare që mundësojnë pranueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve përtej kufijve, duke krijuar kështu infrastrukturë globale për të mbështetur tregtinë, proceset e aprovimit rregullator, si dhe besueshmëri në zinxhirin e furnizimeve.

Këto marrëveshje, që mbulojnë ekonomitë që përfaqësojnë 96% të BPV-së globale (*Burimi: Forumi Ekonomik Botëror*) menaxhohen nga IAF, në fushat që mbulojnë akreditimin e trupave certifikues, si dhe ILAC, në fushat e akreditimit të laboratorëve dhe trupave inspektuese. Ky sistem ndihmon në sigurimin që puna e kryer nga trupat akreditues të jetë konsistente në gjithë globin, si dhe të ruajë standardet ndërkombëtare nga njëri trup akreditues tek tjetri. Si pasojë, produktet dhe shërbimet e testuara, inspektuara apo të certifikuara një herë nën ombrellën e IAF-së apo ILAC-së mund të pranohen çdokund me të njëjtën besueshmëri. Kështu, akreditimi zbut asimetritë apo dallimet në informata ndërmjet operatorëve në zinxhirët globalë të vlerave si dhe shërben si

mjet i komunikimit global ndërmjet partnerëve tregtarë ndërkombëtarë.

Hulumtimi i kryer nga Qendra për Ekonomi dhe Hulumtime Afariste (CEBR) në MB ka gjetur që 6.1 miliardë funta të eksporteve plotësuese të MB-së në vit mund t'i atribuohen standardeve dhe vlerësimit të akredituar të përputhshmërisë çdo vit. Ai raporton që blerësit kanë besim që produktet do të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin, kështu që janë të pranueshme më gjerësisht. Sistemi largon barrierat teknike shtetërore arbitrare ndaj tregtisë, rrit besimin dhe transparencën në të gjithë zinxhirët kompleksë dhe shumëkombësh të furnizimit.


### RAST STUDIMI

**Certifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë në Zinxhirët e Furnizimit (SCSMS)** Trupat akreditues vlerësojnë kompetencën e trupave certifikues për të dhënë certifikata për Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Zinxhirëve të Furnizimit (ISO 28000). Standardi obligon organizatat që të themelojnë, implementojnë e vazhdimisht të përmirësojnë sistemin e menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë aspektet kritike të ofrimit të sigurisë së zinxhirit të furnizimeve. Këto aspekte përfshijnë rreziqet si kërcënimet nga terrorizmi, mashtrimet dhe pirateria, që kanë implikime serioze ndaj biznesit.



## Rritja e njohjeve

Në vitet e fundit, ka pasur një trend në rritje drejt njohjes më të gjerë të akreditimit, si dhe të pranueshmërisë së marrëveshjeve nga qeveritë dhe rregullatorët. Për shembull, marrëveshjet e reja tregtare të nënshkruara nga Bashkimi Evropian (BE) me Japoninë, Kanadanë, Zvicrën dhe Tunizinë përmendin shfrytëzimin e vlerësimit akredituar të përputhshmërisë për të siguruar tregti të lirë e të harmonizuar. Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit (GCC) operon me një sistem të vetëm Rregullator të Tregut, që i referohet akreditimit si mjet esencial për implementimin e sistemit rregullator, si dhe përdoret në të gjitha rregulloret për të siguruar kompetencën e trupave të njoftuar. APEC (Bashkëpunimi Ekonomik Azi-Paqësor) pranon akreditimin si bazë mbështetëse për komponentin e vlerësimit të përputhshmërisë së marrëveshjeve të APEC-së. ASEAN (Asociacioni i



Pajisje elektrike dhe elektronike, si mënyrë e të demonstruarit që kriteret specifike janë përmbushur.

Pranueshmëria e gjerë e akreditimit nga organet rajonale dhe rregullatorët shtetërorë të vendeve individuale po ashtu i ndihmon qeverive anëtare të OBT-së që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre brenda Marrëveshjes për Barrierat Teknike ndaj Tregtisë, si dhe Marrëveshjes për Masat Sanitare dhe Fito-Sanitare.

Shfrytëzimi i akreditimit po ashtu njihet në qarqe të tjera. Në MB, Instituti i Drejtorëve njeht certifikimin e akredituar me ISO 9001 si masë në raportin e tyre vjetor të Qeverisjes së Mirë, siç bën edhe Indeksi i Inovacionit Global, që rendit ekonominë sipas performancës së tyre. Një raport së voni publikuar nga AIRMIC, Asociacioni i Menaxherëve të Riskut, ka pranuar vlerën e akreditimit si vegël e kostimit të rrezikut.

### RAST STUDIMI

#### Cilësia dhe gjurmueshmëria e zinxhirit furnizues të Intermarché

Zinxhiri francez i supermarketeve, Intermarché, shfrytëzon një platformë që i mundëson të identifikojë, analizojë dhe monitorojë të gjithë furnizuesit, komponentët dhe repartet prodhuese në zinxhirin e furnizimeve të veta, që përfshin mbi 4,200 furnitorë në vende, në të gjitha nivelet, si dhe ka grumbulluar certifikatat e tyre të cilësisë mjedisore.

Ata arrijnë të vënë në hartë të gjitha entitetet e ndryshme të përfshira në zinxhirin e furnizimeve, të marrin dhe verifikojnë certifikimet e furnizuesve, si dhe të bëjnë rekomandime të shënjestruara në bazë të kontrolleve të proceseve tek secili furnizues. Kjo i mundëson kompanisë, qoftë si prodhuese edhe shitëse, të identifikojë prejardhjen e produkteve, si dhe të ulë rreziqet.

## Shërbimet e akreditimit: Vlera e shtuar në zinxhirin e furnizimit

Akreditimi funksionon përgjatë gjithë zinxhirëve sektoralë të furnizimeve, që variojnë nga shëndetësia e pajisjet mjekësore, ndërtimi, energjia, veshmbathjet dhe tekstilet, lodrat dhe elektronika, TI dhe komunikimet, e deri tek siguria e ushqimit dhe furnizimi me ujë.

Akreditimi ofron një gamë shërbimesh që mund të shtojnë vlerën dhe menaxhon rreziqet potenciale në zinxhirët e furnizimit, përmes vlerësimit të shërbimeve të certifikimit, inspektimit, testimit dhe kalibrimit. Me demonstrimin e kompetencës, paanshmërisë, si dhe kapacitetit të këtyre organizatave, përforcohet kredibiliteti i mallrave e shërbimeve, ndërsa i mundësohet menaxherëve të prokurimit dhe zinxhirit të furnizimeve të menaxhojnë më mirë rreziqet e





## Përkrahja për Zyrtarët e Prokurimit



### Gjetja e furnizuesit

IAF "CertSearch", që do të lansohet para Ditës Botërore të Akreditimit, është mjet që mbështet zyrtarët e Prokurimit. Platforma aktualisht përmban 700,000 certifikata të sistemeve menaxhuese nga furnizues të akredituar, si dhe i mundëson blerësve të kontrollojnë nëse furnizuesit e tyre potencialë kanë certifikata të tilla. Kjo pritet të ndihmojë edhe në bërjen e dallimit ndërmjet certifikatave të lëshuara nga trupat e akredituar të vlerësimit të përputhshmërisë (CABs) si dhe certifikatave të lëshuara nga CAB-të e paakredituar, si dhe në kontrollimin e autenticitetit të certifikatave.

[www.iaf.certsearch.org](http://www.iaf.certsearch.org)

#### RAST STUDIMI

##### Skemat e Sigurisë në Prokurim

Skemat e Sigurisë në Prokurim (SSIP) është forum që mëton të mbështesë bizneset e vogla duke harmonizuar parakualifikimet si dhe duke ulur shpenzimet dhe burokracinë në fushat e shëndetit dhe sigurisë brenda zinxhirit të furnizimeve.

Anëtarësimi i regjistruar në SSIP është i hapur për skemat e vlerësimit të Shëndetit e Sigurisë si palë të treta, duke përfshirë skemat e vlerësimit të shëndetit e sigurisë si ato që operohen nga kontraktorët e mëdhenj, apo shoqatat tregtare. Skemat e Anëtarëve të Regjistruar përfitojnë nga një njohje e ndërsjellë dydrejtimeshe me skemat tjera të regjistruara, por edhe Trupat Vlerësues të Certifikimit, përmes Skemës së Sektorit SSIP UKAS.

Të dhënat e marra nga Portali SSIP vërtetojnë kursimet e industrisë, që nga viti 2016, në mbi 124 milionë funta, pas marrëveshjes së vendosur të njohjes së ndërsjellë mes gjithë anëtarëve të forumit. Skema SSIP i ofron menaxherëve të prokurimit qasje në mbi 71,000 organizata që janë verifikuar nga procesi i vlerësimit për shëndet e siguri. Akreditimi verifikon pajtueshmërinë me legjislacionin, si dhe mbështet konsistencën ndërmjet skemave anëtare.

## Informata të mëtutjeshme

Akreditimi ofron një mënyrë të njohur globalisht jo vetëm për vlerësimin dhe kontrollimin e riskut të operimit të brendshëm të bizneseve, por edhe për produktet dhe shërbimet që ata plasojnë në treg. Në këtë mënyrë, rregullatorët, blerësit dhe punëtorët mund të demonstrojnë besimin që akreditimi ofron një botë më të sigurt.

Vizito <http://www.publicsectorassurance.org> për të fituar qasje në hulumtime, raste studimi dhe informata mbështetëse që lidhen me dobitë pozitive të akreditimit në zbatimin e politikave të shëndetit e sigurisë.

Vizitoni [www.businessbenefits.org](http://www.businessbenefits.org) për shembuj të tjerë se si bizneset mund të përfitojnë nga standardet dhe akreditimi.



### Sekretariati ILAC

Tel: +612 9736 8374

Email:

[ilac@nata.com.au](mailto:ilac@nata.com.au)

Faqja: [www.ilac.org](http://www.ilac.org)



@ILAC\_Official



<https://www.youtube.com/user/IAFandILAC>



### Sekretariati IAF

Tel: +1 (613) 454 8159

Email: [iaf@iaf.nu](mailto:iaf@iaf.nu)

Faqja: [www.iaf.nu](http://www.iaf.nu)



@IAF\_Global



<http://www.linkedin.com/company/international-accreditation-forum-inc>



<https://www.youtube.com/user/IAFandILAC8>